



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 2867/12 Prot.

Pogradec, më 27. 07. 2023

VENDIM

Nr. 76 datë 26.07 2023

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE Z. SHKËLQIM BACI, PËR DËMET E SHKAKTUARA NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESË

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të pikës 1 të nenit 29, të ligjit nr. 139/2015, "Për Veteqeverisjen Vendore", të neneve 4, 7 dhe 41, të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile" dhe të kapitullit III të V.K.M nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerezore", me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Pogradec për mbështetje financiare të shtetases Shkëlqim Baçi, për dëmtimin e banesës së tij nga rënia e zjarrit në datën 10.07.2023
2. Miratimin e dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Pogradec.
3. Ti akordojë familjes së shtetases Shkëlqim Baçi, ndihmën emergjente në vlerën prej **428636 Lekë** nga buxheti i Bashkisë Pogradec, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec për vitin 2023.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Emergjencave Civile, Strehimi dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative, si dhe Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare të Bashkisë Pogradec.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas shpalljes:

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

